



Gjatë tre viteve të para të jetës, fëmijët rriten jo vetëm fizikisht, por edhe kognitivisht (mendërisht). Çdo ditë, teksa ndërveprojnë me mjedisin dhe mësojnë për të, ata krijojnë lidhje dhe rrugë të reja midis qelizave nervore në tru dhe midis trurit e trupit. Rritja fizike matet me centimetra dhe kilogramë, ndërsa ajo mendore është paksa më e vështirë për t'u përcaktuar.

*Megjithatë, dijet tona të deritanishme bazohen te vëzhgimet e kujdesshme të teoricienëve të mëdhenj si Piazhë, Erikson, etj. Në vitet e para, fëmijët ndërmarrin hapa të mëdha në aftësinë e tyre për menduar, për të zgjidhur probleme dhe për të komunikuar – këto aspekte përbëjnë **zhvillimin kognitiv**.*

Teksa shqisat e tyre dhe muskujt zhvillohen, foshnjat e palëvizshme bëhen eksplorues të vegjël. Për ju, këto aktivitete mund të jenë frustruese, por ato tregojnë se fëmija juaj po bën hapa përpara në zhvillimin kognitiv, se truri i tij/i saj po zhvillohet dhe po i jep fuqi të mendojë dhe të mësojë për botën përreth.



**Qendra Ekonomike e
Zhvillimit dhe Edukimit të
Fëmijëve.**

**Këshilla për zhvillimin
konjitiv tek fëmijët
(2-3) vjeç**

**Adresa: Rruga e Barrikadave.
Nr.tel. 042222991**



Këshilla për zhvillimin konjitiv tek fëmijët 2-3 vjeç

Fëmijët 24-36 muaj

Rreth moshës 2-vjeçare, fëmija mund të përdorë fjali me 2-3 fjalë dhe të përdorë përemrat vetorë “unë”, “ti” dhe “mua”. Ai mëson shumë fjalë dhe kuptohet më lehtësisht kur flet.

Në moshën 3-vjeçare, fëmija do të përdorë fjali me 3-5 fjalë ose dhe më shumë; do të fillojë të mësojë që të mbajë radhën kur flet dhe të bëjë një bisedë të shkurtër me ju.

Fëmija mëson të flasë për gjërat që i kanë ndodhur gjatë ditës. Me ndihmën tuaj, do të mundet t'i rendisë ngjarjet për të treguar një histori. Në këtë moshë, fëmija do të flasë për njerëz dhe objekte që nuk janë me të: “P.sh, gjyshja në shtëpi” ose “topi im në kosh”.

Fëmija fillon të kuptojë koncepte si koha dhe të kundërtat (nata/dita, e madhe/e vogël). Ai fillon të dallojë sesi duken gjërat e ngjashme (mollat janë të kuqe dhe të rrumbullakëta). Nëse fëmija ju ka pranë teksa eksploron, do ndihmohet të provojë gjëra të reja dhe të eksplorojë i/e pavarur.

Aktivitete për të stimuluar zhvillimin kognitiv

Inkurajoni aftësitë e jetës së përditshme:

të përdorë lugën, të pijë nga një filxhan dhe të heqë kapelen. Këto aftësi përfshijnë lëvizjet motorrike të mëdha dhe të vogla, por edhe e ndihmojnë fëmijën të mendojë për atë që po bën.



Bisedoni me fëmijën, duke emërtuar dhe biseduar për gjërat e përditshme: pjesët e trupit, lodrat dhe sendet në shtëpi. Kjo ndihmon në zhvillimin e aftësive gjuhësore. Në këtë periudhë, mund t'i mësoni fëmijës se, p.sh., një karrige mund të jetë e madhe dhe e kuqe.

Lexojini fëmijës. Mund të inkurajosh të folurit dhe imagjinatën, duke lexuar së bashku, duke treguar histori, duke kënduar këngë dhe duke recituar vjershat e çerdhes.



Gatvani me fëmijën: kjo e ndihmon të pëlqejë ushqimet e shëndetshme, të mësojë fjalë të reja dhe të kuptojë koncepte matematikore: si "1 lugë", "30 minuta" ose "gjysmë" .